



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	AGJENCIJA KUNDËR KORRUPTIONIT / AGENCE PUBLIQUE KORUPCJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK / DMP	Nr. Prot. 03-128/14
Dep. N. 1.1.1.1. Broj. 01	Datum. 16.01.2014
Broj. 01	Datum. 16.01.2014
Nr. prot. 01	Datum. 16.01.2014

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA  
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr. Regj. 18225/2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Ramiz Kryeziu nga fsh. Belivorc K. Kamenicë për kundërvajtje nga neni 8 par. 1 i ndëshkuar sipas nenit 17 par. 1.1 te Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.l pik. 8 te Ligjit mbi kundërvajtje, me dt. 16.09.2013 merr këtë

#### A K T V E N D I M

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtës ndaj Ramiz Hysen Kryeziu, i lindur më 30.04.1957 ne Muqiverc, tani me vendbanim në fsh. Belivorc K. Kamenicë, këshilltar ne ministrin për mirëqenie dhe punë sociale, për kundërvajtje nga 8 par. 1 i ndëshkuar sipas nenit 17 par. 1.1 te Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave për te gjithë personat zyrtar Konform neni 198 al.l pik. 8 te LMK-es Pezullohet Procedura ,pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës

#### A r s y e t i m

**Agjencia Kundër Korruptionit**, parashtri kërkesën nr. 01 -1828/2012 të dt 18.05.2012, për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të lartpërmendorit e për kundërvajtjen e lartekur, duke propozuar të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari në shkallë të parë, me dt. 31.10.2012, ka marrë aktvendim me të cilin ka shpallur përgjegjës dhe e ka dënuar me gjobë në shumë prej 1000 eu. Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ne afatin ligjor ka paraqit Ankesë në Gjykatën e Lartë për kundërvajtje. E cila ka marrë aktvendimin GJL. nr. 1414/2012 dt. 12.12.2012, ka aprovuar ankesën e te pandehurit si të bazuar, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka Abroguar, dhe lenden e ka kthyer në rivendosje, me qelim qe te vërtetohet se nga provat e administruar gjatë procedurës nuk ka pas provë e cila dëshmon se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen me te cilën ngarkohet, dhe te merr veprimin qe ti analizojet provat e afruar një nga një dhe te gjitha se bashku për te konstatuar te drejtën materiale dhe qe te vërteton nga provat kundërvajtjen e kryer, Duke vepruar sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë u dëgjuat dëgjohet menaxheri i personelit ne Ministrin për Mirëqenie dhe punë sociale, Adem Bajgora i cili në deklaratën e tij pohoj se sa i përket rasti te Ramiz Kryeziu mund te potencoj edhe njëherë se deklaratën qe e kam dhanë te ju se me kohë kam pranuar formularin nga agjencisconi dhe menjëherë te gjithë punëtoreve te Ministrisë, qe janë në listën e Ministrisë ja kam dërguar në imell adresën e tyre, dhe sa ai përket rastit Kryeziu ky nuk ka pas as imell zyrtare as private te dhanë në Ministri, ndërsa formularit në mënyre fizike në si person nuk kemi mundur te ja dërgojmë fizikisht, formularin pasi qe i njëjti edhe këshilltar por nuk vjen në punë apo vie rrallë, nuk dimë se ku ta gjiejmë konkretisht pasi qe është këshilltar politik i ministrit dhe unë nuk kam pas mundësi qe te ja dërgoj fizikisht dhe nuk kam mund qe te gjejë në ministrin po ashtu nr.te telefoni të tij nuk kam qe ta njoftoj, këto janë shkaqet qe nuk ja kam dërguar formularin zyrtar po ashtu me duhet te theksoj se një vite me herët në mënyrë të rregullt e ka deklarua pasurin dhe ketë e ka ditë,

Ne deklaratën e dhanë të parashtuesit te kërkesës Enis Sadiku i cili në deklaratën e tij pohoj se sa i përket rastit në fjalë precizimin për kërkesën e ushtruar te cilën e kemi ushtruar ndaj Ramiz Kryeziu ku sipas ligjit me dt. 04 L/050 mos deklarim i pasurisë nga neni 8 par. 1.2 sipas dispozitës ndëshkuese te nenit 17 1.1 shihet se deklarimet janë prapa në mënyrë taksativë me ketë ligj dhe me rastin konkret kemi pas te bëjmë me deklarimin e rregullt vjetor i cili është i përcaktuar me nenin 8 i cili paraqet dhe kohen e çdo deklaruesi te pasurisë i cili është i obliguar prej dt. 01.03. deri me d.t 31.03 çdo vit kalendarik i cili nuk e ka mbush ketë obligim ne afatin lidhur . Konsideroj se kërkesa është e arsyeshme dhe e bazuar dhe mbetem ndaj saj.

Gjyqtari pasi që administroi provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoj gjendjen faktike, duke e dëgjuar parashtuesin e kërkesës dhe deklarimi i dëshmitarit si dhe provat e tjera të administruara nga shkresat e lëndës, dhe duke vepruar sipas konstatimeve sugjerimet te Kolegit te shkalles se dytë, dhe prova te tjera te administruar ne lend, gjyqtari konform neni 198 al.l pik. 8 te LMK-es e PEZULLOI procedurën kundërvajtës ndaj te lartpërmendorit. pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje.

Andaj u vendos si një dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes**

**GJYQTARI**

**Fatmir Behrami**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të ushtrojnë palët, Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmjet të këtij Divizioni.